



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1571/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Telekom i Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Mitrovicës – Qendra për Punë Sociale, me seli në Mitrovicë, rr.“Bedri Gjinaj”, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson e përfaqëson L.Z. avokat në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2629/2022 të datës 28.07.2023, me datë 08.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Telekom i Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2629/2022 i datës 28.07.2023, VËRTETOHET..

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.2629/2022 të datës 28.07.2023, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Mitrovicës – Qendra për Punë Sociale, ndërsa Urdhrin Përmbarimor P.nr.412/22, i lejuar me datë 02.12.2022, nga Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, anulohet.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa, të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor, apo aktvendimi i ankimuar të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur debitori, duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e kreditorit, me propozim që të refuzohet në tërësi ankesa, ashtu që aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Telekom i Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, me datë 01.12.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit Komuna e Mitrovicës – Qendra për Punë Sociale, me seli në Mitrovicë, rr.“Bedri Gjinaj”, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës nr.191031092659/2149, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet debitori që t’ia paguaj kreditorit shumën prej 213.54 Euro.

Përmbartuesi privat Ilmi Miftaraj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.412/2022 të datës 02.12.2022, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbartim. Kundër këtij urdhri përmbartimor debitori me datë 14.12.2022, ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se fatura në bazë të së cilës është iniciuar procedura nuk është e përshtatshme për përmbartim, nuk është pranuar në mënyrë të rregullt dhe si e tillë nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Më tej, ka theksuar se e njëjta faturë nuk është as e pranuar dhe as e nënshkruar nga personat kompetent pranë debitorit, dhe si e tillë nuk i plotëson kushtet për të qenë e përshtatshme për përmbartim në kuptim të nenit 27 të LPP-së. Për këto arsye, ka propozuar që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 21.12.2022, duke e kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetim se i njëjti nuk i plotëson kushtet në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së. Ka shtuar se janë të pabazuara pretendimet e debitorit se i njëjti nuk është njoftuar me faturat për pagesë, ngase debitori në baza mujore ka pranuar çdo muaj faturat përmes email, e po ashtu kreditori në vazhdimësi ka komunikuar me zyrtarët përgjegjës të debitorit duke i njoftuar këta të fundit për detyrimet e papaguara. Më tej, ka theksuar se të gjitha shërbimet janë shfrytëzuar nga ana e debitorit deri me datë 31.12.2021, konform kërkesës së tij, ndërsa mos protokollimi i fatura siç pretendon debitori është çështje e tij e brendshme. Andaj ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2629/2022 të datës 28.07.2023, me të cilin ka pranuar si të bazuar prapësimin dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.412/2022 të datës 02.12.2022.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se në faturë nuk janë përshkruar shërbimet e ofruara debitorit dhe në të njëjtën nuk është përcaktuar saktë shuma e cila është detyrim për periudhën kohore për të cilën është lëshuar fatura, për arsye se në faturë është përcaktuar borxhi paraprak i mbetur në lartësi prej EUR 179.70, mirëpo nuk është treguar se si ka rrjedhur ky borxh i debitorit, për cilat shërbime apo për cilën periudhë kohore. Tutje gjykata ka theksuar se fatura nuk është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe e njëjta nuk rezulton të jetë pranuar nga debitori. Ndërsa, në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë provë me të cilën dëshkohet se kjo faturë i është dorëzuar debitorit në ndonjë mënyrë të rregullt, dhe si e tillë, fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri paraqet dokument të njëanshëm. Andaj, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, për këtë arsye urdhrin e përmbaruesit privat e ka anuluar.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore Dhomat e Shkallës së Dytë i vlerësojnë edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, ku përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: faturat. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç është fatura nr.191031092659/2149, për shumën e detyrimit prej 213,54 Euro, por e njëjta nuk është e përshtatshme për përmbarim për arsye se në faturën kontestuese nuk është shënuar se mbi bazën e cilit shërbim të ofruar debitorit kreditori ka lëshuar të njëjtën në shumën prej 213.54 Euro, po ashtu në faturën e lëshuar nga kreditori shihet se është përfshirë edhe borxhi paraprakë e për të cilin nuk rezulton arsyetim se si ka rrjedh ky borxh, cilës periudhe i përket dhe për çfarë shërbimi është krijuar. Po ashtu nga provat shkresore rezulton fatura mbi bazën e se cilës është lejuar përmbarimi nuk është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit, e njëjta nuk është pranuar nga debitori, çka nënkupton se fatura kontestuese është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit.

Gjykata ankimor vlerëson se në këtë çështje juridike përmbarimore nga propozimi për përmbarim i kreditorit i cili është paraqitur tek përmbaruesi privat me datë 01.12.2022, është vërtetuar se kreditori e kërkon borxhin në shumë prej 213.54 Euro, pa cekur se si është krijuar borxhi në fjalë mbi bazën e cilit shërbim të kreditorit, po ashtu në propozim nuk është cekur as periudha kohore për të cilën kërkohet borxhi, nga ku rezulton se edhe propozimi për përmbarim nuk është lëshuar konform dispozitave ligjore të LPP-së, konkretisht nenit 38 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së.

Andaj, në këtë drejtim rezultojnë si të pathemelta pretendimet ankimore të kreditorit të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara, ndërsa aktvendimin e ankimuar vendosi që ta vërtetojë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1571/2023, me datë 08.02.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi